سلفي
SELEFI.ORG

BETEJA E UHUDIT



‘ABDUL-MUHSIN IBËN MUHAMED EL-KASIM

IMAM DHE HATIB NË XHAMINË E NDERUAR
PROFETIKE NË MEDINE


بسم الله الرحمن الرحيم

Beteja e Uhudit

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirëshmit, Mëshirëplotit.

Të gjitha lavdet dhe falenderimet janë për Allahun, Zotin e gjithësisë. Lavdërimet dhe paqja qofshin mbi Profetin tonë, Muhamedin, si dhe mbi Familjen e tij dhe të gjithë Sahabët e tij.

E më pas:

Shkaku i betejës së Uhudit:

Allahu e dërgoi Profetin tonë, Muhamedin – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, pas një periudhe kohore të stërgjatur pa asnjë të Dërguar, kur jeta ishte e tejmbushur me errësirat e injorancës dhe mjegullnajat e devijimit të asaj kohe. Pikërisht atëherë zuri fill misioni i Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, i shoqëruar nga Sahabët e tij fisnikë, që të përhapë këtë fe përtej horizonteve. Por, njerëzit e kufrit dhe inatit u çuan në këmbë që ta ndalojnë thirrjen e tij dhe nxorrën shpatat që ta luftojnë atë. Mandej, ata u përballën në Bedër dhe aty u realizua triumfi i parë i besimtarëve, me ndihmën e Allahut.

Kështu, u ngritën lartë flamujt e Islamit, kurse idhujtarët u kthyen mbrapa në Mekke të shpartalluar. Secili prej tyre qante për të vrarin e tij dhe vajtonte për belanë e tij. Ata kishin pësuar një traumë shumë të rëndë. Atëherë, Kurejshët vendosën që të përgatiteshin sërish për t’u përballur me muslimanët, saqë kaluan një vit të plotë duke bërë përgatitjet. Kështu, u tubuan luftëtarët e tyre.

Koha kur ndodhi kjo betejë:

Ushtria e tyre u nis në drejtim të Medines Profetike në muajin Sheual të vitit të tretë mbas Hixhretit, me qëllim që të hakmerreshin për ditën e Bedrit.

©Selefi.org

Vendi ku ndodhi kjo betejë:

Idhujtarët u dislokuan pranë malit Uhud, në veri të Medines së ndritur, në skajin e luginës. Nga ana tjetër, ishin disa burra nga muslimanët të cilët ndjenin keqardhje që nuk kishin marrë pjesë në betejën e Bedrit, prandaj ata i kërkuan Profetit që të dilnin me të që të përballeshin me ushtrinë e idhujtarëve. Kështu, muslimanët vendosën njëzëri që të nisen për t’u përballur me ta.

Mbasi që Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – fali me njerëzit namazin e xhumasë, ai hyri në shtëpinë e tij dhe pastaj doli i përgatitur për luftim, i veshur me armaturën ushtarake. Atëherë ai tha:

ما يَنْبَغِي لنبيٍّ لَبِسَ لَأْمَتَهُ أن يَضَعَها حتى يُحَكِّمَ اللهَ بينَه وبينَ عَدُوِّهِ.

“*Nuk i takon asnjë Profeti që ka veshur armaturën ushtarake, ta heqë atë ende pa gjykuar Allahu mes tij dhe armikut të tij*.”[1]

Tradhtia e munafikëve:

Pastaj u nis Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – me njëmijë burra. Kur ndodheshin midis Medines dhe Uhudit, u lanë në baltë nga ‘AbdUllah ibën Ubej – i cili ishte koka e munafikëve – dhe bashkë me të iku një e treta e ushtrisë. I Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – i la që të largohen, pastaj vazhdoi marrshimin derisa u dislokua në një prej grykave të Uhudit, në skajin e luginës, pranë malit, duke e vendosur ushtrinë e tij me shpinën kah Uhudi. Kurse, ushtria e idhujtarëve u vendos ndërmjet ushtrisë së muslimanëve dhe qytetit të Medines.

Sahabët e vegjël në moshë:

Kur erdhi mëngjesi i ditës së shtunë, ai filloi rreshtimin e ushtrisë gati për luftim. Ai doli i veshur me dy palë parzmore dhe nxorri përpara ata që ishin të rinj në moshë. Ata që ishin të vegjël për të marrë pjesë në luftim, ai i ktheu mbrapa, kurse të tjerët

[1] E ka transmetuar Ahmedi në *Musnedin* e tij, 3/351.

 ©Selefi.org

i lejoi që të luftonin. Prej atyre që i lejoi të luftonin ishte Semurah ibën Xhundub dhe Raafi’u ibën Khudejxh – *radijAllahu ‘anhuma* – dhe të dy ata ishin pesëmbëdhjetë vjeçarë.

Numri i idhujtarëve:

Edhe idhujtarët poashtu u përgatitën për luftim. Forca e tyre përbëhej prej tre mijë burrash, prej të cilëve dyqind ishin kalorës. Komandanti i tyre ishte Ebu Sufjani. Ata donin që të shuanin dritën e Allahut dhe të devijonin robërit e Allahut.

Numri i muslimanëve:

Muslimanët ishin shtatëqind burra, të cilët donin triumfin ose shehidllëkun. Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – u dha kurajo Sahabëve të tij që të luftonin, i nxiti që të bënin durim dhe të qëndronin të patundur në luftim. Ai caktoi 40 burra që të vendoseshin mbi kodrën e harkatarëve dhe urdhëroi ‘AbdUllah ibën Xhubejrin – *radijAllahu ‘anhu* – që t’i udhëhiqte ata. Ai u dha urdhër të prerë që të qëndrojnë pa lëvizuar në vendin e tyre, qoftë edhe sikur të shohin ndonjë shpend grabitqar që i sulmon për t’i rrëmbyer. Ai u tha atyre:

إن رأيتُمونا تَخطفُنا الطَّيرُ، فلا تبرَحوا من مَكانِكُم هذا حتَّى أُرْسِلَ لَكُم،
وإن رأيتُمونا هزَمنا القومَ وأوطَأناهُم فلا تبرَحوا حتَّى أُرْسِلَ إليكُم.

“*Edhe nëse na shikoni që po na rrëmben ndonjë shpend grabitqar, ju mos lëvizni nga vendi juaj ku jeni pozicionuar, derisa të vijë lajmëtari te ju. Edhe nëse shikoni që po i mundim dhe po i shtypim armiqtë, prapëseprapë ju mos lëvizni nga vendi juaj, derisa të vijë lajmëtari te ju.*”[2]

Fillimi i betejës:

Dy ushtritë dolën përballë njëra-tjetrës. U afruan dy taboret, i zhveshën shpatat e tyre, nxorrën përpara heshtat e tyre dhe tendosën harqet e tyre. Atëherë dha urdhër

[2] E ka transmetuar Bukhari në Sahihun e tij, me numër 3039.

Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – që të fillonin luftimin. Luftëtarët iu afruan njëri-tjetrit, kalorësit u përplasën me njëri-tjetrin dhe lufta u ndez flakë. Në fillim epërsia ishte e muslimanëve. Allahu zbriti ndihmën e Tij mbi muslimanët, kurse idhujtarët s’dinin nga t’ia mbanin. Flamuri i tyre ra në shesh dhe ata filluan t’ia mbathnin me të katërta.

Shkaku i disfatës së muslimanëve:

Kur harkëtarët e panë që idhujtarët po humbisnin, menduan se idhjutarët nuk do të ktheheshin më, prandaj disa prej tyre filluan të zbrisnin nga kodra për të mbledhur plaçkën e luftës. Ata e braktisën vendin e tyre, të cilin i kishte urdhëruar Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – që ta ruanin me çdo kusht. Komandanti i tyre i rikujtoi që ata s’duhet të largoheshin kurrësesi nga pozicioni i tyre, por ata zbritën dhe ai front mbeti i hapur.

Atëherë, Khalid ibën Uelidi – i cili akoma nuk e kishte braktisur shirkun – u shkëput dhe kaloi nga mbrapa kodrës së harkëtarëve. Mbasi që i vrau ata dhjetë harkëtarë që kishin mbetur në kodër, ushtria e muslimanëve gjendej mes kalorësve të idhujtarëve, të cilët po u vinin nga mbrapa, dhe këmbësorëve të tyre, të cilët po u vinin nga përpara. Idhujtarët i futën në mes muslimanët dhe një pjesë e tyre u shpartallua, kurse pjesa tjetër që kishte mbetur u shpërndanë. Një numër prej tyre u vranë, Allahu qoftë i kënaqur prej tyre dhe i kënaqtë ata! Idhujtarët u rimblodhën rreth flamurit të tyre, ndërsa radhët e muslimanëve u shkapërderdhën. Ndodhi ajo që kishte dashur Allahu që të ndodhte! Allahu nderoi në atë betejë ata që kishte dashur Ai t’i nderonte me shehidllëk!

Tentativa për të vrarë Profetin – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –:

Profeti - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* - qëndroi i palëkundur, ndërkohë që të tjerët e lanë vetëm! Ai i thirri ata që të fitojnë ahiretin e tyre, derisa u rikthyen tek ai disa prej tyre. Idhujtarët arritën t’i afrohen Profetit - *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* -, duke dashur që ta vrasin. Ata arritën që ta çajnë në fytyrë dhe i thyen dhëmbin e përparmë. Nga goditjet e idhujtarëve, dy prej hallkave të helmetës iu ngulën në

fytyrë, si dhe ia thyen helmetën mbi kokën e tij. Helmeta ishte përkrenarja e hekurt që vendos kalorësi mbi kokën e tij. Madje e gjuajtën me gurë derisa ai u rrëzua në njërën anë, pastaj u rrëzua në një nga gropat që kishte gërmuar Ebu ‘Amir el-Fasik, që të binin muslimanët në to. ‘Alij ibën Ebij Talib – *radijAllahu ‘anhu* – i zgjati dorën Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – dhe e tërhoqi lartë. Pastaj, Talha ibën ‘UbejdUllah e mbuloi atë me krahët dhe trupin e tij. Ndërkohë, përpara tij u vra Mus`ab ibën ‘Umejr. Atëherë, idhujtarët arritën deri tek i Dërguari – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, por papritur u dolën përpara gati dhjetë burra prej muslimanëve, të cilët luftuan heroikisht derisa u vranë të gjithë. Pastaj doli përpara Talha ibën ‘UbejdUllah – *radijAllahu ‘anhu* –, i cili luftoi trimërisht me të gjithë ata, derisa i largoi nga Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –. Papritur, dikush ia copëtoi dorën atij. Atëherë, përpara doli Ebu Duxhaneh dhe e mbuloi Profetin me trupin e tij, kurse idhujtarëve u ktheu shpinën. Shigjetat binin mbi shpinën e tij, kurse ai qëndroi ashtu pa lëvizur nga vendi i tij, si mburojë për të Dërguarin e Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –.

Befas, Shejtani bërtiti me të madhe: “U vra Muhamedi!” Kjo i drodhi zemrat e shumë prej muslimanëve saqë shumica e tyre ia mbathën me të katra.

﴿وَكَانَ أَمۡرُ ٱللَّهِ قَدَرٗا مَّقۡدُورٗا ٣٨﴾

“**Urdhëri i Allahut është një vendim që nuk kthehet mbrapa kurrë.**”[3]

Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – përjetoi mundime të tmerrshme:

Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – u nis drejt muslimanëve, ndërsa ata, sa e panë, u mblodhën të gjithë përreth tij dhe filluan të tërhiqeshin me të drejt grykës së malit, ku ishin pozicionuar në fillim. Ata u mbështetën të rraskapitur mbas malit. ‘Ali ibën Ebij Talib – filloi të lante gjakun nga fytyra e Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – dhe i hodhi ujë mbi kokë. Kur e pa bija e tij, Fatimeja, që uji nuk po e ndalte gjakderdhjen, përkundrazi po e shtonte akoma më shumë, atëherë mori një copë xunkthi, e dogji dhe hirin e tij ia ngjiti plagës, derisa gjakderdhja u ndal.

[3] El-Ahzab, 38.

Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – përjetoi aq mundime të tmerrshme, saqë kur deshi të ngjitej sipër një shkëmbi atje, nuk arriti dot që të ngjitej mbi të për shkak të plagëve që kishte marrë. Atëherë, shkoi Talha – *radijAllahu ‘anhu* – dhe u ul në rrëzë të shkëmbit që Profeti të hipte mbi të dhe pastaj të ngjitej mbi shkëmb.

Njerëzit u tmerruan kur morën vesh për të rënët e tyre. Pastaj zbriti i Dërguari i Allahut – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – dhe i pa shehidët që kishin rënë në betejë. Ata ishin gjymtuar si mos më keq. Ai kërkoi Hamzën, xhaxhain e tij – *radijAllahu ‘anhu* – derisa e gjeti te lugina, me bark të shqyer, me hundë dhe veshë të prerë.

Idhujtarët u kthyen në kampin e tyre, ndërsa në tokë gjendeshin trupa të copëtuar dhe njerëz që po jepnin shpirt.

Numri i shehidëve:

E gjithë kjo ka ndodhur në ditën e shtunë. Beteja mbaroi me kaq. Rezultati i saj ishte 70 shehidë nga radhët e muslimanëve dhe 22 të vrarë nga mesi i idhujtarëve. Të vrarët tanë janë në Xhenet, kurse të vrarët e idhujtarëve janë në Xhehenem!

Uhudi ishte triumf e jo disfatë:

Pra, beteja e Uhudit ishte një triumf e nuk ishte disfatë. Ka thënë Allahu i Pastër nga çdo mangësi:

﴿ذَٰلِكَ وَلَوۡ يَشَآءُ ٱللَّهُ لَٱنتَصَرَ مِنۡهُمۡ وَلَٰكِن لِّيَبۡلُوَاْ بَعۡضَكُم بِبَعۡضٖۗ
وَٱلَّذِينَ قُتِلُواْ فِي سَبِيلِ ٱللَّهِ فَلَن يُضِلَّ أَعۡمَٰلَهُمۡ ٤ سَيَهۡدِيهِمۡ وَيُصۡلِحُ بَالَهُمۡ ٥ وَيُدۡخِلُهُمُ ٱلۡجَنَّةَ عَرَّفَهَا لَهُمۡ ٦﴾

“**Kështu pra! Po të donte Allahu, Ai do t’i kishte shkatërruar ata, por Ai ju sprovon juve me njëri-tjetrin. Kurse ata që u vranë në Rrugën e Allahun, assesi nuk kanë shkuar dëm veprat e tyre. Ai do t’i udhëzojë dhe do ta përmirësojë gjendjen e tyre. Si dhe do t’i fusë në Xhenetin që ua ka përshkruar atyre tashmë!**”[4]

[4] Muhamed, 4-6.

 ©Selefi.org

Ajo ishte një betejë e tejmbushur me mësime dhe përfitime. Ngjarjet e kësaj beteje janë faqe të mbushura me lavdi, të cilat do të trashëgohen brez pas brezi. Për të, Allahu zbriti 60 ajete në Librin e Tij të qartë, ajete të cilat lanë gjurmë të thella në shpirtin e Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, saqë ai i kujtonte ato edhe kur ishte në prag të vdekjes.

Sakrifica e Sahabëve për këtë fe:

Me të vërtetë që kjo fe mbërriti deri te ne mbasi që u dhanë sakrifica të mëdha nga Sahabët dhe Selefët e këtij Umeti, të cilët shijuan hidhësirën e fatkeqësive dhe sprovave. Enes ibën Nadr – *radijAllahu ‘anhu* – u plagos në këtë betejë me shtatëdhjetë e ca plagë. Pastaj, e kapën armiqtë dhe e gjymtuan kufomën e tij deri në atë masë, saqë nuk e njohu dot askush tjetër përveç motrës së tij, e cila e njohu nga maja e gishtërinjve. Ndërsa, Sa’d ibën Rabij’ – *radijAllahu ‘anhu* – në trupin e tij kishte shtatëdhjetë plagë.

Pra, Sahabët fisnikë kanë meritën e shoqërimit të Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, meritën që paraprinë në Iman dhe meritën që ishin të parët që marrshuan në Rrugë të Allahut. Disa prej tyre u gjymtuan, kurse disa të tjerë u copëtuan; ata i lanë gratë vejusha dhe u vetëflijuan për këtë fe, derisa mbërriti kjo fe deri tek ne, e plotë dhe e pacunguar. Prandaj, njihe meritën e tyre dhe falenderoji për kontributin e tyre, thuaj për ta “*radijAllahu ‘anhum*” (Allahu qoftë i kënaqur prej tyre) sepse me të vërtetë që Zoti i tyre i deshi dhe ishte i kënaqur prej tyre!

Pasoja e keqe e gjynaheve:

Gjynahet të sjellin bela të mëdha. U shuan jetë të tëra në atë betejë për shkak të një gabimi. Ademi doli nga Xheneti për shkak të një gjynahu.

دخَلَتِ امرَأَةٌ النَّارَ في هِرَّةٍ

“*Një grua hyri në Zjarrin e Xhehenemit veçse për shkak të një maceje!*”[5]

[5] E ka transmetuar Bukhari (nr.3318) dhe Muslimi (nr.2619).

Prandaj, ti o musliman duhet t’i përmbahesh me rigorozitet bindjes dhe nënshtrimit për Allahun, se kështu do të të vijë ndihma kur të jesh në vështirësi dhe kështu do të çlirohesh nga barra e rëndë e fatkeqësive. Mos i bëj veprat e tua të këqija ushtri që të lufton ty; e sa më shumë që t’i shtosh gjynahet, aq më shumë i shtohet fuqia kësaj ushtrie armike që të lufton ty!

Sahabët e rinj në moshë:

Në këtë betejë luftuan Semura dhe Rafi’u – *radijAllahu ‘anhuma* –, të cilët ishin të dy në moshë pesëmbëdhjetë vjeçare.

Pabesia e munafikëve:

Largohu nga shoqëria e keqe, sepse ata të lënë në baltë pikërisht në momentet kur ti ke më së shumti nevojë për ta! Ata janë shokë për ty kur ti je në mirësi, por ke për t’i gjetur armiq kur të jesh në vështirësi. Kështu pra, edhe njerëzit e munafikllëkut i lanë në baltë Sahabët kur ata ishin në situatën më kritike. Prandaj, edhe ti o musliman mbahu fort mbas shoqërisë së njerëzve të mirë, sepse ata janë mbrojtës për ty, qoftë në prezencën tënde, e qoftë në mungesën tënde; ata gjithmonë përpiqen të të ndihmojnë dhe të të ruajnë.

Fitorja vjen me durimin:

E vërteta zhytet, por assesi nuk mbytet. Kurse, e pavërteta sado lartë që të ngrihet, prapëseprapë do të shuhet. Ndërsa fundi i lavdishëm është si gjithmonë për devotshmërinë. Prandaj, mos i humb shpresat për rregullimin e shoqërisë dhe as mos u dëshpëro për udhëzimin e tyre, sepse Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – duroi pavarësisht dëmtimeve dhe plagëve që mori, derisa njerëzit hynë turma-turma në fenë e Allahut.

Qafirat të cilët hynë në Islam:

Rezultatet e çështjeve janë plotësisht në Dorë të Allahut, prandaj vazhdo me davetin dhe mos i ndal duatë, sepse udhëzimi i njerëzimit - në fund të fundit - është në Dorë të Krijuesit të njerëzimit! Ebu Sufjani në betejën e Uhudit udhëhoqi idhujtarët nën sloganin: “I lartësuar qoftë idhulli Hubel!” Ndërsa, në betejën e Çlirimit të Mekkes thoshte: “S’ka të adhuruar tjetër me të drejtë përpos Allahut!” Uahshiu vrau Hamzën – *radijAllahu ‘anhu* –, por më vonë pranoi Islamin dhe ishte pikërisht ai që vrau profetin e rremë, Musejlemeh Kedhabin! Prandaj, ruaje veten tënde - o ti musliman - nga ndryshimi i vazhdueshëm i zemrës, sepse:

القلوبَ بين إصبعين من أصابعِ اللهِ يقلِّبُها كيف يشاءُ

“*Zemrat janë midis dy Gishtave prej Gishtave të të Gjithëmëshirëshmit dhe ai i rrotullon ato si të dojë!*”[6]

Andaj, lutju Allahut vazhdimisht që të të japë qëndrueshmëri të përherëshme!

Pendimi i Khalid ibën Uelidit:

Robi, sado që të zhytet në mosbindje ndaj Allahut, prapëseprapë pendimi e shlyen të gjithë barrën e gjynaheve, edhe nëse ato arrijnë deri në kupë të qiellit. Khalid ibën Uelidi udhëhiqte kalorësinë e kufrit dhe nga dora e tij u vranë elita e Sahabëve. Por, prapëseprapë, me pendim falen të gjitha gabimet! ‘Amër ibnul-‘Aas – *radijAllahu ‘anhu* – i tha Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –:

“Unë po ta vë kusht për pranimin e Islamit që të më falen gjynahet e mia!”

Atëherë, Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – i tha:

أما علمْتَ يا عمْرُو أنَّ الإسلامَ يهْدِمُ ما كان قَبْلَه؟

[6] E ka transmetuar Muslimi në *Sahihun* e tij, me numër 2654.

“*A nuk e paske marrë vesh o ‘Amër që Islami i fshin krejt ato që janë bërë më përpara?!*” E ka transmetuar Muslimi.[7]

Kështu që, shpëtoje veten tënde nga moçali i gjynaheve dhe kthehu te Zoti yt duke u larguar nga mëkatimi, sepse veprat e mira i fshijnë veprat e këqija!

Djemtë e xhaxhait të Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – ishin pikërisht ata që luftuan kundër tij:

Mos u trego kryeneç dhe të heqësh dorë nga kjo fe sepse për këtë fe është derdhur gjak. Njeriu mund të sprovohet me të afërmit dhe kushurinjtë e tij, prandaj bëj durim kur të përballesh me dëmtimet që t’i shkaktojnë ata. Kushërinjtë e Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – lanë atdheun e tyre dhe pasuritë e tyre dhe u nisën drejt Medines për të vrarë Profetin – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –. Ata bënë kundër tij gjëra që nuk i bënë shumica e qafirave, siç ishte gjymtimi dhe përdhosja e kufomave të muslimanëve, ndonëse ata ishin djemtë e xhaxhait të Profetit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –. Por në çlirimin e Mekkes, ai i fali dhe i amnistoi ata. Ai u tha atyre:

أَنْتُمْ الطُّلَقَاءُ

“**Jeni të lirë!**”[8]

Prandaj, merre Profetin – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – si shembull për veten tënde, shembull në vetpërmbajtjen e zemërimit dhe faljen e të tjerëve. Mbaji lidhjet me farefisin tënd dhe anashkaloji dëmtimet që t’i shkaktojnë ata.

Rëndësia e madhe që ka pajtimi:

Në përçarje dhe konflikte shkojnë dëm mundimet, ndërsa në bashkim dhe në pajtim dëlirësohen zemrat. Prandaj, ruhu nga përçarja e unitetit dhe nga mosmarrëveshjet në mendime sepse këto të dyja janë disfata e vërtetë!

﴿وَلَا تَنَٰزَعُواْ فَتَفۡشَلُواْ وَتَذۡهَبَ رِيحُكُمۡۖ وَٱصۡبِرُوٓاْۚ﴾

[7] E ka transmetuar Muslimi në Sahihun e tij, me numër 121.
[8] Sirah Ibën Hisham, vëll.2/fq.412.

“**Andaj mos hyni në konflikte me njëri-tjetrin sepse kështu keni për të dështuar dhe do t’ju ikë fuqia juaj, prandaj bëni durim!**”[9]

Gjendjet ndryshojnë vazhdimisht në dynja:

Mos i zër besë gjynahut kur me të shijon njëfarë gëzimi, sepse ëmbëlsia e atij gëzimi mund të përzihet me hidhësirën e dëshpërimit! Sahabët – *radijAllahu ‘anhum* – u gëzuan me plaçkën e luftës, prandaj zbritën harkëtarët nga kodra që ta mbledhin atë, por ama i zuri disfata nga mbrapa!

Dynjaja nuk qëndron përherë në një gjendje të vetme, prandaj bëj durim përgjatë sprovave të dynjasë dhe falëndero Allahun për mirësitë që të ka dhënë në të.

Profeti – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – është njeri në fund të fundit dhe ai s’ka në dorë as dëmin e as dobinë:

Profetët janë robër, janë krijesa, preken nga ato gjendje që preken të gjithë njerëzit e tjerë. Ata nuk duhet të ngrihen në një gradë më të lartë sesa grada e të qënurit robër të Allahut, por as nuk duhet të ulen assesi nga pozita e tyre që meritojnë. Profeti Muhamed – sa*l-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – doli në mejdan me dy palë parzmore, i veshur me uniformën ushtarake. Sahabët luftuan trimërisht krah për krah tij. Xhibrili dhe Mikaili zhvilluan përkrah tij një luftim epik. Por, pavarësisht krejt kësaj që ndodhi, Profeti u plagos në fytyrën e tij dhe iu thye dhëmbi i tij i përparmë. Dhe e gjithë çështja mbetet në Dorë të Allahut, si fillim e si mbarim. Kështu që, Allahu i Pastër nga çdo mangësi është i Vetmi që ka në Dorë dëmin dhe dobinë. Po të kishte patur në dorë Profeti – ‘*alejhis-salatu ues-selam* – diçka prej dëmit dhe dobisë, ai padyshim që s’do të kishte lejuar që të derdhej gjaku i tij! Andaj, bëje të gjithë ibadetin tënd për të Lartmadhërishmin që ka nënshtruar gjithçka, përule veten tënde përpara Ngadhënjimtarit të vërtetë, sepse kështu do të realizohet plotësisht rrugëtimi jot, me lejen e Allahut!

[9] El-Enfal, 46.

Nuk lejohet kërkimi i bereqetit nga mali Uhud:

Nuk lejohet që të kërkosh bereqetin nga dheu i Uhudit dhe as nuk lejohet që të mblidhen guralecët e tij. Te mali i Uhudit u vranë shtatëdhjetë prej Sahabëve, atje u plagos i Dërguari – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* –, e nëse dheu e gurët e Uhudit do të kishin ndofarë ndikimi, atëherë s’do të kishte patur përreth tij asnjë viktimë. Kështu që, çështjet e tua besoja Allahut dhe mbështetu gjithmonë tek Allahu për largimin e fatkeqësive.

Besnikëria e të Dërguarit – sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem – ndaj Sahabëve të tij:

Prej veprave burrërore është edhe mirënjohja për atë që i ka shërbyer fesë dhe prej virtyteve të bukura është besnikëria ndaj shokëve. Kujtimi i gjakut të shehidëve të Uhudit mbeti në shpirtin e të Dërguarit – *sal-lAllahu ‘alejhi ue sel-lem* – deri në vitin kur ai vdiq. Ai e fali namazin e xhenazes për shehidët e Uhudit mbas tetë vjetësh, si dhënie lamtumire për ta.[10] Kështu pra, ai i nderoi fisnikët e kësaj feje! Edhe ti, o musliman, duhet ta ruash dashurinë për shokët e tu të ngushtë, duhet ta ruash hakun që meriton shoqëria e tyre dhe duhet t’i ruash sekretet e tyre. Ka thënë Ebu Sufjani – *radijAllahu ‘anhu* –: “Nuk kam parë askënd që të dojë dikë tjetër ashtu siç e donin Sahabët Muhamedin!”[11]

Urtësia e sprovave:

Xheneti nuk fitohet ndryshe veçse duke kaluar urën e vështirësisë dhe rraskapitjes, duke kaluar në rrugën e gjatë e të mundimshme, e cila është e tejmbushur me lodhje dhe pengesa. Edhe sprovimi me humbje dhe disfatë ka poshtërim dhe përulje, por ama ky sprovim sjell më mbas krenarinë dhe triumfin. Allahu i Pastër nga çdo mangësi, kur do që t’i japë lavdi robit të Tij, fillimisht e godet atë me sprova, mbasandej do të vijë lartësimi i tij, në varësi të përuljes dhe nënshtrimit të tij për Allahun.

[10] E ka transmetuar Ebu Davudi në *Sunenin* e tij, me numër 3224.
[11] *Sirah Ibën Hisham*, vëll.4/fq.126.

Allahu ka përgatitur për robërit e Tij besimtarë grada të larta në Xhenetet e Nderimit, grada të cilat ata nuk i arrijnë dot me veprat e tyre dhe as nuk i arrijnë dot me diçka tjetër perveçse me sprovime dhe bela. Prandaj, Allahu u dha atyre shkaqet që do t’u mundësojnë arritjen e atyre gradave, shkaqe që janë sprovimet dhe belatë, që të pastrojë brendësinë e zemrave dhe për të larguar sëmundjet e fshehta. Kështu që, ti o musliman duhet të jesh i kënaqur me atë që është caktuar për ty dhe duhet t’i nënshtrohesh kaderit që ka vendosur Allahu. Ka thënë dikush nga Selefët:

“Po të mos ishin sprovat, ne do të kishim ardhur në ahiret të falimentuar tërësisht!”[12]

Ditët në jetën e dynjasë nuk janë kurrë njësoj, nuk qëndrojnë kurrë në të njëjtën gjendje. Herë ka fitore e herë ka humbje, herë ka lavdi e herë ka poshtërim, herë ka sëmundje e herë ka shëndet, herë ka pasuri e herë ka varfëri; prandaj shfrytëzoji mirësitë e tua në dynja që t’i depozitosh për ahiretin tënd. E kush i jep përparësi dynjasë së tij, padyshim që do ta dëmtojë fenë e tij dhe ahiretin e tij.

Lavdërimet dhe paqja e Allahut qofshin mbi Profetin tonë, Muhamedin, si dhe mbi Familjen e tij dhe të gjithë Sahabët e tij.

Përktheu: Alban Malaj
Tiranë më 21/11/2026 miladij
E shtunë, 11 Xhumade el-Akhir 1448 hixhrij

[12] Zad el-Me’ad, vëll.4/fq.176.